



Kanton Bern
Canton de Berne



Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Elterninformation zur Volksschule Albanisch

Bildungs- und Kulturdirektion



2 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Pasqyra e lëndës

Hyrja.....	3
Shkolla fillore	4
Organizimi i shkollës fillore	5
Nxitja dhe mbështetja	10
Prindërit dhe shkolla fillore	12
Përkatësia	15

Impressum

Herausgeberin und Copyright:
Bildungs- und Kulturdirektion
Amt für Kindergarten, Volksschule und Beratung
akvb.bkd@be.ch

Auflage 2022

Download: www.be.ch/Volksschule

Hyrja

Kjo broshurë ju informon mbi sistemin shkollor në kantonin Bernë.

Ajo jep përgjigje në këto pyetje:

- Si janë ndërtuar kopshti i fëmijëve dhe shkolla?
- Çfarë pret shkolla nga prindërit?
- Çfarë mund të bëjnë prindërit që fëmijët e tyre të ndihen mirë në shkollë dhe të mund të mësojnë mirë?

Arsimtarët dhe drejtorja e shkollës në komunat ju qëndrojnë me kënaqësi në dispozicionin për informacione të mëtejshme.

4 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Shkolla fillore

Tëpërgjithshmet

Allgemeines

Koha e detyrueshme shkollore zgjat, si rregull, njëmbëdhjetë vjet.

Në vitin, në të cilin fëmija juaj deri më dt. 31 korrik mbush katër vjeç, fillon koha e shkollës fillore (kopshti dyvjeçar). Nëse prindërit e dëshirojnë, ata mund të lënë që fëmija e tyre të hyjë edhe një vit më vonë në vitin e parë të kopshtit të fëmijëve.

Shkolla u jep falas nxënëseve dhe nxënësve mjetet mësimore dhe materialet shkollore.

Vajzat dhe djemtë shkollohen së bashku. Për të dyja gjinitë vlejné të njëjtat objektiva të të mësuarit.

Shkolla fillore është neutrale nga ana fetare.

Në çdo komunë komisionet shkollore janë përgjegjëse për aktivitetet e kopshteve të fëmijëve dhe shkollave.

Nëse prindërit dëshirojnë që fëmija e tyre të vizitojë një shkollë private, prindërit i paguajnë shpenzimet e shkollës.

Fëmijët dhe të rinjtë, të cilët për shkak të aftësisë së kufizuar nuk mund të shkollohen në shkollën fillore, mund të ndjekin një shkollë të veçantë.

Objektivat e shkollës fillore

Ziele der Volksschule

Shkolla fillore ndërmjetëson njohuri dhe shkathtësi. Këto e formojné bazën për kualifikimin e mëvonshëm profesional, për ndjekjen e shollave që çojné më tej dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Shkolla kontribuon në zhvillimin e aftësive, kujdeset për një klimë të respektit dhe tolerancës së ndërsjellë dhe e nxit veprimtarinë me përgjegjësi ndaj njerëzve të tjerë dhe mjedisit.

Lehrplan 21

Personave mësimdhënës nga kopshti i fëmijëve deri në vitin e 9-të të shkollës "Lehrplan 21" iu shërben si busull, i cili i mbështet ata në planifikimin e mësimit.

Organizimi i shkollës fillore

	Shkalla sekondare II Sekundarstufe II Kualifikimi profesional ose shkolla e mesme (p.sh, mësimi profesional ose gjimnazi)	2 – 4 vjet	
Shkolla e detyrueshme fillore Volksschule	Sekundarstufe I (viti 7-9 shkollor) Sekundarstufe I Niveli i shkallës sekondare ose niveli i shkollës reale	3 vjet	
	Shkalla primare (viti 1-6 shkollor) Primarstufe	6 vjet	Shkalla primare 4 vjet
			Basisstufe/ Cycle élémentaire 3-5 vjet
	Kopshti i fëmijëve Kindergarten	2 vjet	

Kopshti i fëmijëve

Kindergarten

Fëmijëve të vitit të parë dhe të dytë të kopshtit të fëmijëve iu jepet mësim së bashku në një klasë. Kopshti i fëmijëve iu ofron fëmijëve një hapësirë të jetës, lojës dhe përvojës. Ai ka si qëllim që ta stimulojë dhe nxisë zhvillimin dhe të mësuarit. Lidhur me këtë merren parasysh kushtet e ndryshme dhe aftësitë e ndryshme të të mësuarit si dhe ritmi i të mësuarit.

Parimisht pas dy vjetësh në kopshtin e fëmijëve të gjithë fëmijët hyjnë në vitin e 1–rë të shkallës primare. Sipas gjendjes së zhvillimit një fëmijë, si përjashtim,

mund të hyjë një vit më parë ose një vit më vonë në vitin e parë të shkallës primare.

Në disa komuna fëmijëve të kopshtit të fëmijëve dhe të të dy klasave të para të shkollës iu jepet mësim plotësisht ose pjesërisht së bashku (në mosha të përziera) në “Basisstufe” në “Cycle élémentaire”.

6 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Shkalla primare (viti 1-6 shkollor)

Primarstufe (1.-6. Schuljahr)

Nga viti i 1-rë deri në vitin e 6-të shkollor nxënëset dhe nxënësit mësohen në lëndë të ndryshme si p.sh. «gjuhë», «matematikë» ose «krijim». Nxënëset dhe nxënësit mësojnë dhe punojnë gjithnjë e më shumë në mënyrë të pavarur dhe me vetpërgjegjësi.

Duke filluar nga viti i 3-të shkollor nxënëset dhe nxënësit në pjesën gjermanofolëse të kantonit mësojnë si gjuhë të parë të huaj frëngjisht, që nga viti i 5-të shkollor anglisht.

Pas shkollës primare fëmijët hyjnë në shkollën sekondare I. Shkolla i informon fëmijët dhe prindërit në vitin e 5-të shkollor në mënyrë të detajuar mbi procedurën e kalimit në shkollën sekondare I.

Shkalla sekondare I (Viti shkollor 7 - 9)

Sekundarstufe I (viti 7-9 shkollor)

Në shkollën sekondare I nxënëset dhe nxënësit mësohen në nivelin e shkollës reale ose në nivelin e shkollës sekondare. Në nivelin e shkollës sekondare vlejnë kërkesa më të larta sesa në nivelin e shkollës reale.

Nxënëset dhe nxënësit i përcaktohen nga personi mësimdhënës nivelit përkatës në bazë të zhvillimit të parashikuar.

Në mësimin e shkollës sekondare I janë me rëndësi formimi i përgjithshëm dhe zgjedhja e qëllimit të ardhshëm të formimit dhe profesionit. Shkolla e mbështet këtë proces të rëndësishëm. Prindërit, personi mësimdhënës i klasës dhe këshillimorja për zgjedhjen e profesionit (falas) i shoqërojnë së bashku të rinjtë në zgjedhjen e profesionit të tyre.

www.be.ch/biz

Pas shkollës fillore

Nach der Volksschule

Pas kohës së detyrueshme të shkollës të rinjtë kryejnë një kualifikim profesional dy deri katërvjeçar ose ndjekin një shkollë të mesme.

Informacione më të hollësishme për formimin profesional bazë:

www.be.ch/berufsbildung

Informacione për shkollat e mesme të specializuara dhe gjimnazin:

www.be.ch/mittelschulen

Viti shkollor dhe pushimet shkollore Schuljahr und Schulferien

Shkolla fillon në mes të gushtit dhe mbaron në fillim të korrikut. Fëmijët dhe të rinjtë kanë 38 ose 39 javë mësim në vit. Në rast të 39 javëve shkollore pushimet janë të shpërndara si vijon:

- Pushimet e vjeshtës në shtator, tetor: tre javë
- Pushimet dimërore në dhjetor, janar: dy javë
- Pushimet e sportit: një javë
- Pushimet e pranverës në prill: dy javë
- Pushimet verore në korrik, gusht: pesë javë

Të dhënat e sakta për pushimet dhe ditët e festave pa shkollë mund të gjenden në faqen e internetit të shkollës ose të komunës.

Orari i mësimave

Stundenplan

Mësimi bëhet nga e hëna deri të premte. Një orë mësimi zgjat 45 minuta. Paradite ka të paktën katër orë mësimi. Fillimi dhe fundi i mësimit janë unikë (kohë blloku). Pasdite koha e mësimave varion (dy deri katër orë mësimi). Sipas vitit shkollor dhe klasës një ose disa pasdite janë pa shkollë.

Si prindër ju jeni përgjegjës që fëmija juaj të vizitojë mësimin sipas orarit të mësimave. Gjatë kohës së mësimit shkolla është përgjegjëse për mbikëqyrjen e fëmijëve.

Jashtë kohës së mësimit dhe në rrugën e shkollës fëmijët janë nën kujdesin e prindërve. Përjashtimi: Rruga e shkollës konsiderohet e papranueshme, dhe nxënëset dhe nxënësit kanë nevojë për një transport të organizuar nga shkolla.

8 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Mungesa dhe dispensacione

Absenzen und Dispensationen

Një fëmijë nuk lejohet të mungojë në mësim pa justifikim ose leje të drejtorisë së shkollës. Lajmëroni personin mësimdhënës sa më parë të jetë e mundur, jo më vonë sesa deri në fillim të mësimit, mbi mungesën e fëmijës. Arsye për mungesa të justifikuar: fëmija është i sëmurë, rast vdekjeje në familje, ndërrimi i banesës, vizitë tek mjeku ose dentisti.

Prindërit kanë të drejtë që në pesë gjysmëditë në vitin shkollor të mos i çojnë fëmijët e tyre në shkollë pa dhënë arsye. Por personat mësimdhënës duhet të informohen paraprakisht.

Në rast të festimit të festave të larta fetare, ngjarjeve të rëndësishme familjare, vizitave të kursit në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK), kryerjes së stazhit për njohjen profesionale drejtoria e shkollës mund të japë një dispensacion. Miratimi i një dispensacioni duhet të merret nga drejtoria e shkollës me kohë.

Detyrat e shtëpisë

Hausaufgaben

Të mësuarit shkollor bëhet në mësim. Detyrat e shtëpisë i shërbejnë përgatitjes para dhe pas mësimit. Një fëmijë duhet të jetë një gjendje që t'i bëjë detyrat e shtëpisë pa ndihmën e prindërve ose personave të tjerë të rritur.

Koha maksimale për detyrat e shtëpisë në javë:

- 30 minuta për vitin e 1-rë/ 2-të shkollor
- 45 minuta për vitin e 3-të deri në vitin e 6-të shkollor
- 90 minuta për vitin e 7-të deri në vitin e 9-të shkollor

Personat mësimdhënës ia përshtatin detyrat e shtëpisë aftësisë individuale të të mësuarit dhe të kapacitetit.

Vlerësimi**Beurteilung**

Në radhë të parë vlerësimi i shërben nxitjes dhe duhet të përjetohet nga fëmija si mbështetje e të mësuarit të vet.

Në çdo vit shkollor personi mësimdhënës i klasës i fton prindërit për një bisedë (bisedë për gjendjen e arritur). Në këtë bisedë bisedohet për arritjet shkollore dhe gjendjen e të mësuarit dhe të zhvillimit të nxënëses ose të nxënësit. Me dëshirën e prindërve mund të ndodhin biseda shtesë.

Nxënëset dhe nxënësit marrin në fund të vitit të 2-të shkollor si dhe në fund të vitit të 4-rt deri të 9-të shkollor një raport vlerësimi me shkrim. Në këtë vlerësohen arritjet në lëndët e ndryshme. Që nga viti i 4-rt shkollor arritjet e nxënësve dhe nxënësve në raportin e vlerësimit vlerësohen me nota.

10 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Nxitja dhe mbështetja

Masa mbështetëse

Unterstützende Massnahmen

Fëmijë me sfondin në gjuhë të huaj mund të marrin mësim shtesë në Gjermanisht si gjuhë e dytë.

Nëse një fëmijë ka aftësi të veçanta intelektuale, ai mund të ndjekë, pas një sqarimi, oferta të nxitjes për nxënësit e talentuar.

Vështirësi në të mësuarit

Lernschwierigkeiten

Vështirësi të fëmijës në të mësuarit sqarohen, me pëlqimin e prindërve, nga një person i specializuar ose zyrë e specializuar (këshillimorja kantonale për edukim). www.be.ch/erziehungsberatung

Masa të thjeshta të pedagogjisë speciale

Einfache sonderpädagogische Massnahmen

Masa të thjeshta të pedagogjisë speciale siç janë p.sh. nxitja integrale, logopedi, psikomotorika, shërbejnë që t'i mbështetin nxënëset dhe nxënësit gjatë ndjekjes së shkollës së rregullt.

Fëmijët e vitit të 1-rë shkollor, të cilët kanë nevojë për pak më shumë kohë për lëndën mësimore, mund ta përvetësojnë lëndën brenda dy viteve.

Nëse fëmijët me gjithë mbështetjen nuk i arrijnë objektivat e të mësuarit, ata mund të marrin mësim dhe të vlerësohen sipas objektivave individuale të të mësuarit.

Klasa të veçanta

Besondere Klassen

Fëmijët e shkallës primare ose shkallës sekondare I me vështirësi në të mësuarit kanë në shumë komuna mundësinë që të ndjekin një klasë të veçantë. Në një klasë të veçantë ka vetëm pak nxënëse dhe nxënës. Kështu personi mësimdhënës mund t'i mbështetë nxënësit më mirë gjatë të mësuarit.

Masa të përforcuara të pedagogjisë speciale

Verstärkte sonderpädagogische Massnahmen

Për fëmijë, të cilët nuk mund të shkollohen mjaftueshëm me këtë ofertë të mbështetjes, ka masa të përforcuara të pedagogjisë speciale – ose në shkollën fillore të rregullt, ose në një shkollë fillore të veçantë.

Shkolla ditore**Tagesschule**

Për fëmijët, të cilët kanë nevojë për përkujdesje jashtë kohëve të mësimi, komuna ofron një shkollë ditore:

- Përkujdesje para fillimit të mësimi
- Përkujdesje gjatë drekës me ushqim
- Përkujdesja gjatë pasditeve pas mbarimit të mësimi ose në pasditet pa shkollë

Ofertat e shkollës ditore janë vullnetare për prindërit. Shpenzimet për vizitën e shkollës ditore ndryshojnë për prindërit sipas të ardhurave, pasurisë dhe madhësisë së familjes.

Informacione të përgjithshme për shkollën ditore:

www.be.ch/schulergaenzende-angebote

Informacione për ofertën e shkollës ditore në komunën e banimit prindërit i marrin tek personi mësimdhënës i klasës, drejtorja e shkollës ose komuna.

Informacione për oferta të tjera të përkujdesjes për fëmijët (qendra të kujdesit ditor për fëmijë, prindër ditorë etj.) prindërit marrin tek komuna e banimit:

www.fambe.sites.be.ch

Puna sociale në shkollë**Schulsozialarbeit**

Punonjësja sociale në shkollë ose punonjësi social u ofrojnë fëmijëve dhe të rinjve ndihmë dhe këshillim në probleme sociale ose personale. Persona mësimdhënës, drejtoritë e shkollave dhe prindërit mund t'i drejtohen gjithashtu punës sociale shkollore.

Shëndeti**Gesundheit**

Fëmijë dhe të rinj vizitohen në kopshtin e fëmijëve si dhe në vitin e 4-rt dhe të 8-të shkollor nga mjekja ose mjeku. Vizita është e detyrueshme dhe falas për prindërit.

Çdo vit kontrollohen edhe dhëmbët e fëmijëve dhe të të rinjve nga dentistja shkollore ose dentisti shkollor. Kjo vizitë është gjithashtu e detyrueshme dhe falas.

Nëse pas një vizite nevojiten sqarime të tjera ose një trajtim, informohen prindërit.

12 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Prindërit dhe shkolla fillore

Bashkpunimi

Zusammenarbeit

Prindërit dhe shkolla fillore janë të detyruar me ligj për të bashkëpunuar. Të rëndësishme për bashkëpunimin janë një shkëmbim i rregullt informacionesh si dhe mirëkuptim, besim dhe respekt i ndërsjellë.

Informacione reciproke

Gegenseitige Information

Shkolla i informon prindërit mbi ngjarje dhe plane të rëndësishme në lidhje me mësimin (aktivitete, udhëtime shkollore etj.) dhe me aktivitetet e shkollës (caktimi për shkollën ose klasën, kohët e mësimit, mjetet mësimore, rregullat shkollore etj.). Këto informacione jepen me shkrim ose në mbrëmjet e prindërve.

Një element kryesor për bashkëpunimin midis shkollës dhe shtëpisë prindërore është biseda për gjendjen e arritur.

Në marrëveshje me personin mësimdhënës prindërve iu lejoheq që të bëjnë në çdo kohë një vizitë në mësim.

Prindërit lutën që të informojnë personin mësimdhënës të klasës, nëse fëmija vuan nga sëmundjet ose duhet të marrë rregullisht ilaçe ose në rast të ngjarjeve, të cilat e cenojnë zhvillimin dhe vëmendjen e fëmijës.

Përkthim

Übersetzung

Është me rëndësi që prindërit të kuptojnë se çfarë bisedohet në një mbrëmje për prindërit ose gjatë një bisede për gjendjen e arritur. Gjithashtu është me rëndësi që prindërit të mund të shprehin kërkesat e tyre dhe të mund të shtrojnë pyetje. Nëse prindërit nuk flasin gjermanisht ose frëngjisht mjaftueshëm mirë, mund të dëshirohet një përkthyes ose një përkthyes.

Vendime të rëndësishme

Wichtige Entscheide

Të gjitha vendimet për karrierën shkollore të fëmijës (për shembull kalimi nga shkalla primare në shkollën sekondare I ose përcaktimi për një klasë të veçantë) bisedohen me fëmijën dhe me prindërit.

Prindërit kanë të drejtë, që të informohen, dëgohen dhe këshillohen nga personat mësimdhënës të fëmijës dhe nga drejtorja e shkollës. Prindërit mund t'i shikojnë të gjitha dosjet lidhur me fëmijën e vet. Një vendim për karrierën shkollore urdhërohet nga drejtorja e shkollës dhe mund t'u komunikohet dhe arsyetohet prindërve me shkrim. Nëse prindërit nuk janë dakord me këtë vendim, ata kanë mundësi që të parashtrijnë një ankesë brenda 30 ditësh tek inspektorati shkollor.

Bashkëveprimi i prindërve

Mitwirkung der Eltern

Shumë shkolla kanë një këshill të prindërve, i cili përbëhet nga një deri dy përfaqësues të prindërve prej secilës klasë. Këta zgjidhen në fillim të vitit shkollor nga prindërit e klasës. Përfaqësuesit e prindërve bashkëpunojnë ngushtë me personin mësimdhënës të klasës. Këshilli i prindërve e mban kontaktin midis prindërve dhe shkollës.

Më shumë mbi bashkëveprimin e prindërve në kopshtin e fëmijëve ose në shkollë prindërit mësojnë tek personi mësimdhënës i klasës ose tek drejtorja e shkollës.

Probleme në shkollën fillore

Probleme in der Volksschule

Ndoshta fëmija nuk ndihet mirë në klasë, ose arritjet e tij kanë rënë papritmas. Ndoshta fëmija ka vështirësi me fëmijë të tjerë ose prindërit nuk janë dakord me vendimin e një personi mësimdhënës.

Kështu veprojnë prindërit

1. Prindërit dhe personi mësimdhënës lidhin kontakt me njëri-tjetrin. Ata bisedojnë situatën së bashku dhe kërkojnë një rrugë zgjidhjeje. Si rregull gjendet kështu një zgjidhje e kënaqshme.
2. Nëse prindërit dhe personi mësimdhënës nuk gjejnë asnjë zgjidhje dhe njëra palë ose të dyja palët e konsiderojnë të nevojshme, zhvillohet një bisedë midis prindërve, personit mësimdhënës dhe drejtorisë së shkollës.
3. Mund të përfshihen edhe zyra të specializuara si p.sh. puna sociale shkollore dhe këshillimorja për edukim.
4. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, atëherë mund t'i drejtohet inspektoratit shkollor.

Në rast nevoje shkolla organizon një përkthim.

14 Shkolla fillore në pjesën gjermanofolëse të kantonit Bernë

Informacione për prindërit

Ardhja në kantonin Bernë

Zuzug in den Kanton Bern

Fëmijët dhe të rinjtë në moshën 4 deri 15/16 vjeç janë të detyruar për të frekuentuar një shkollë, sapo ata të ndodhen në Zvicër dhe do të qëndrojnë disa muaj në Zvicër.

Informacione për ndjekjen e kopshtit të fëmijëve dhe shkollën e fëmijëve të tyre prindërit e sapoardhur i marrin tek komuna e tyre ose në faqen e internetit të shkollës së komunës së banimit.

Fëmijë dhe të rinj, të cilët kanë mundime me gjuhën e mësimit, mund të marrin mbështetje shtesë për ta mësuar gjuhën.

Të sapoardhur që nga mosha 13 vjeç pa njohuri të gjuhës së mësimit mund të ndjekin një kurs intensiv rajonal (Regionaler Intensivkurs PLUS, RIK+).

Informacione të tjera:

www.bkd.be.ch/migration

Përkatësia

Drejtoria për edukim

Bildungs- und Kulturdirektion

Drejtoria për edukim është autoriteti kantonal në fushën e arsimit. Ajo i përcakton kushtet kornizë për shkollat fillore në komunat dhe lëshon planet mësimore.

Inspektorati shkollor

Schulinspektorat

Inspektorja e shkollës ose inspektori i shkollës ushtron mbikëqyrjen kantonale mbi shkollën fillore.

Komuna

Gemeinde

Komuna është kompetente për organizimin e shkollës fillore në vend. Ajo vë në dispozicion infrastrukturën shkollore: ndërtesën e shkollës, mobilitet dhe mjetet mësimore.

Komisioni i shkollës

Schulkommission

Komisioni i shkollës* kujdeset që fëmijët, sipas legjislacionit kantonal dhe paracaktimeve të komunës suaj, të vizitojnë kopshtin dhe shkollën. Përveç kësaj ai është kompetent për vendime strategjike të shkollës suaj fillore.

Drejtoria e shkollës

Schulleitung

Drejtoria e shkollës është kompetente për udhëheqjen e shkollës fillore. Ndër të tjera ajo iu përcakton fëmijëve klasat e veçanta dhe është kompetente për vendimet lidhur me karrierën e shkollës.

Personi mësimdhënës i klasës

Klassenlehrperson

Personi mësimdhënës i klasës është përgjegjës për udhëheqjen pedagogjike dhe organizative të klasës. Ai është personi i parë i kontaktit për të gjitha pyetjet dhe kërkesat rreth vizitës së fëmijës suaj në kopsht dhe në shkollë.

* Komisioni i shkollës quhet në disa komuna komisioni i arsimit.

